



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 9

Tiranë – E hënë, 8 mars 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas nr. 239, datë 1.3.2021	3
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 2151, datë 4.3.2021	10



KËRKESË
Nr. 239, datë 1.3.2021

**PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË
 APLIKIMIT PËR PËRFITIMIN E
 FINANCIMEVE NGA BUXHETI I
 SHTETIT TË ORGANIZATAVE
 JOFITIMPRURËSE, TË AUTORIZUARA
 NGA MINISTRI I DREJTËSISË, PËR
 OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE
 PARËSORE TË GARANTUAR
 NGA SHTETI**

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në bazë të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, bën publik njoftimin si më poshtë:

Bazuar në nenin 15, pika 3, e ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, organizatat jofitimprurëse të autorizuara për dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje. Procedura, rregullat e përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuara, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”.

Të gjitha organizatat jofitimprurëse të autorizuara për t’u kualifikuar për të përfituar financime, duhet të plotësojnë kriteret e

përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në pikën 6, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, si më poshtë vijon:

a) Kriteret e përgjithshme:

i. të kenë marrë autorizimin nga ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;

ii. të mos kenë dy burime të njëjta financimi për të njëjtin aktivitet (deklaratë e organizatës se nuk përfiton burime të tjera financimi për të njëjtin aktivitet);

iii. të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi që cenon zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes me drejtorin e Ndihmës Juridike Falas (përcjellja e deklaratës së organizatës jofitimprurëse).

b) Kriteret e veçanta:

i. projektpropozimin, i cili përmban të dhënat teknike-financiare për ofrimin e shërbimit, qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë;

ii. të dhëna për personelin, duke specifikuar detyrat dhe duke siguruar jetëshkrimin e tyre;

iii. të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e shërbimeve të ngjashme, duke siguruar dokumente dhe të dhëna të realizimit të shërbimeve të ngjashme në të kaluarën;

Organizata jofitimprurëse e autorizuar duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret e veçanta, duke dorëzuar dokumentet përkatëse sipas thirrjes publike.

Në rast të mosplotësimit të një prej kriterëve të veçanta, aplikimi konsiderohet i paplotë dhe, si i tillë, nuk kualifikohet për përfitimin financiar.

Dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara dhe duhet të dorëzohen me postë



në zyrat e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, brenda datës 15.4.2021, në adresën:

Rruga e Barrikadave, nd. 18, hyrja 6, zyra nr. 10-III, Tiranë.

Për informacione më të detajuara, në lidhje me aplikimin për financim nga buxheti i shtetit dhe formularët që duhet të plotësohen, sipas anekseve lutem klikoni në linkun e mëposhtëm:

ANEKS 1

UDHËZUES MBI THIRRJEN PËR FINANCIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE TË AUTORIZUARA NGA MINISTRI I DREJTËSISË

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas, në mbështetje të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, si dhe të pikës 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, hap thirrjen për aplikime për projekte në fushën e ndihmës juridike parësore¹ për 12 (dymbëdhjetë) organizatat jofitimprurëse të autorizuara nga ministri i Drejtësisë.

Thirrja do të qëndrojë e hapur nga data **1 mars 2021–15 prill 2021**.

Për t’u kualifikuar për të përfituar financime, organizatat jofitimprurëse të autorizuara duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, si më poshtë vijon:

- Kriteret e përgjithshme:

1. Të kenë marrë autorizimin nga ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;

2. Të mos kenë dy burime të njëjta financimi për të njëjtin aktivitet;

3. Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi, që cenon zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

- Kriteret e veçanta:

1. Brenda datës **15 prill 2021**, organizatat jofitimprurëse të autorizuara duhet të përcjellin projektpropozimin, i cili përmban të dhënat teknike-financiare për ofrimin e shërbimit, qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë;

2. Të dhëna për personelin, duke specifikuar detyrat dhe duke siguruar jetëshkrimin e tyre;

3. Të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e shërbimeve të ngjashme, duke siguruar dokumente dhe të dhëna të realizimit të shërbimeve të ngjashme në të kaluarën.

Prioritetet e thirrjes janë si më poshtë:

PRIORITETI 1

- Sigurimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Organizata jofitimprurëse e autorizuar, përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, do të ushtrojë një shumëllojshmëri shërbimesh ligjore në fushën e ndihmës juridike parësore si vijon:

i. dhënia e informacioneve, në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;

ii. dhënia e këshillimit;

iii. dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;

iv. dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;



v. përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe

vi. dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Duke marrë në konsideratë numrin mesatar të rasteve të raportuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore, gjatë periudhës së zbatimit të këtij projekti duhet të synohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore për **300 qytetarë** (25 raste në muaj).

PRIORITETI 2

- Zhvillimi i aktiviteteve promovuese dhe i edukimit ligjor të publikut, në kuadër të ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi shërbimin e ndihmës juridike parësore.

Në kuadër të përmbushjes së këtij prioriteti, organizata jofitimprurëse e autorizuar duhet të planifikojë një kalendar aktivitetsesh, duke specifikuar qëllimin dhe objektivat specifike të projektit, sipas tabelës si vijon:

Muaji	Tema e aktivitetit	Qëllimi i aktivitetit	Target grupi përfitues	Hapat e ndjekur
Qershor	1. 2.			
Korrik	1. 2.			
Gusht	1. 2.			
Shtator	1. 2.			
Tetor	1. 2.			
Nëntor	1. 2.			
Dhjetor	1. 2.			

Duke marrë në konsideratë numrin mesatar të aktiviteteve ndërgjegjësuere të zhvilluara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore, gjatë periudhës së zbatimit të këtij projekti duhet të synohet **zhvillimi i 24 aktiviteteve ndërgjegjësuere/edukimit ligjor të publikut** (2 aktivitete në muaj).

PRIORITETI 3

Bashkëpunimi proaktiv me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe ofruesit e tjerë të shërbimit të ndihmës juridike parësore, në kuadër të forcimit dhe zhvillimit të sistemit të ndihmës juridike parësore (krijimi i një rrjeti ndërinstucional).

SHUMA MAKSIMALE E PROJEKTIT: Fondi total 8.000.000 lekë

Çdo organizatë jofitimprurëse e autorizuar e përzgjedhur nuk mund të përfitojë më shumë se 20% të buxhetit të planifikuar për financimin e dhënies së ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga organizatat jofitimprurëse.

KOHËZGJATJA E PROJEKTIT: 12 muaj
AFATET KOHORE TË THIRRJES

- DORËZIMI I APLIKIMEVE

15 prill 2021, ora 16:00

- SHPALLJA E FITUESVE

maj 2021

- KOHA E ZBATIMIT TË PROJEKTEVE

maj/qershor 2021 e në vazhdim



VIZIBILITETI

Organizatat jofitimprurëse që përfitojnë financim duhet të marrin të gjitha hapat e nevojshëm për të publikuar faktin që Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka financuar veprimin, si edhe do të përdorin në çdo moment logon e Ministrisë së Drejtësisë/Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, duke bashkëvepruar me Drejtorinë e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas përpara çdo publikimi për ruajtjen e logos së Ministrisë, si edhe të përdorimit të formulës së mëposhtme në çdo raste botimesh, kurdoherë që do të nevojitet: “Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e vetme e (organizatës jofitimprurëse) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”.

VËMENDJE

- Lejohen të aplikojnë vetëm organizata jofitimprurëse të autorizuar nga ministri i Drejtësisë.

- Çdo organizatë jofitimprurëse e autorizuar, e përzgjedhur, nuk mund të përfitojë më shumë se 20% të buxhetit të planifikuar për financimin

e dhënies së ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga organizatat jofitimprurëse.

- Në rast se gjatë zbatimit të projektit rezulton dhe vërtetohet se ka pasur paraqitje të dokumentacionit të rremë, të secilit prej dokumenteve të kërkuara në këtë thirrje, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas do të kërkojë kthimin e plotë të shumës së disbursuar dhe do ta dërgojë rastin për ndjekje penale.

- Organizata jofitimprurëse e autorizuar që përfiton financim ka për detyrë të aplikojë objektivat dhe prioritetet dhe garancitë e vizibilitetit, në përputhje me rregullat e komunikimit dhe të vizibilitetit të Ministrisë së Drejtësisë/ Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

DOKUMENTET BASHKËLIDHUR

Aneks 1: Udhëzuesi i granteve

Aneks 2: Formulari i aplikimit

Aneks 3: Formulari i buxhetit

Aneks 4: Lista e dokumenteve

ANEKS 2

THIRRJE PËR FINANCIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE TË AUTORIZUARA NGA MINISTRI I DREJTËSISË

FORMULAR APLIKIMI

PJESA I

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Titulli i projektit	
Emri i organizatës jofitimprurëse	
Statusi ligjor <i>(së bashku me ndryshimet që kanë pësuar aktet themelore të organizatës, duke bashkëngjitur vendimet përkatëse të gjykatës nr.)</i>	<i>Numri i vendimit dhe data e regjistrimit në gjykatë</i> NIPT-i Emri i bankës: Numri IBAN: Nr. i llogarisë bankare (në lek):
Autorizim i ministrit të Drejtësisë	<i>Nr. dhe data e autorizimit nga ministri i Drejtësisë</i>
Adresa:	
Email:	



Website:	
Vendi/et ku zbatohet projekti	
Personi i kontaktit	
Pozita në organizatë	
Fondet e kërkuara nga DNJF-ja:	

PJESA II PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Qëllimi i projektit: Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti u përgjigjet 3 prioriteteve të përcaktuara në thirrje (*maksimumi 10 rreshta*).

[Shpjegoni ...]

Aktivitetet kryesore për secilin prioritet (*maksimumi 5 rreshta përshkrim për secilin aktivitet të planifikuar për secilin nga 3 prioritetet e përcaktuara në thirrje*).

1. [Shpjegoni ...]
2. [Shpjegoni ...]
3. [Shpjegoni ...]
4. [Shpjegoni ...]

Etj.

A janë aktivitetet e propozuara të përshatshme, praktike dhe në përputhshmëri me prioritetet e përcaktuara në thirrje? (*maksimumi 5 rreshta*):

A përmban projekti tregues objektivisht të verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve? (*Maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet*):

Aktiviteti 1:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni

...]

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni

...]

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni

...]

Aktiviteti 4:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Shpjegoni

...]

Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara? (*Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmbledhur, se cili është grupi parësor i synimit të projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e projektit.*) *Maksimumi 5 rreshta*:

PJESA IV BUXHETI

Lutemi të përshkruani shpenzimet e përfshira për implementimin e projektit.

*** Plotëso: Tabelën për kostot financiare të projektit.**



ANEKS 3

Emri i aplikantit:

Titulli i projektit:

Nr.	Lloji i shpenzimit	Njësia	Sasia	Çmimi në lek	TOTALI
SHPENZIMET SIPAS AKTIVITETEVE DHE ZËRAVE PËRKATËS					
	Prioriteti nr. 1: Sigurimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive				
1	AKTIVITETI 1: Titulli ...				
1.1					
1.2					
1.3					
1.4					
1.5					
	TOTAL AKTIVITET _ 1				
				-	-
	Prioriteti nr. 2: Zhvillimi i aktiviteteve promovuese dhe i edukimit ligjor të publikut në kuadër të ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi shërbimin e ndihmës juridike parësore.				
2	AKTIVITETI 1: Titulli ...				
2.1					
2.2					
2.3					
2.4					
	TOTAL AKTIVITET _ 1				
				-	-



	Prioriteti nr. 3: Bashkëpunimi proaktiv me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas dhe ofruesit e tjerë të shërbimit të ndihmës juridike parësore, në kuadër të forcimit dhe të zhvillimit të sistemit të ndihmës juridike parësore (krijimi i një rrjeti ndërinstitucional).				
3	AKTIVITETI 1: Titulli ...				
3.1					
3.2					
3.3					
	TOTAL AKTIVITET _ 1				
				-	-

NB: Ju lutem shtoni linja buxhetore për çdo aktivitet.

Sqarim:

- Parashtrimi i projektit, sipas këtij formulari, përgatitur dhe miratuar nga DNJF-ja, në asnjë mënyrë nuk nënkupton detyrim apo angazhim nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas për të dhënë fonde.
- Vlerat financiare të paraqitura në këtë formular duhet të jenë të përcaktuara në **lek**.

ANEKS 4 LISTA E DOKUMENTEVE

Procesi i aplikimit

1. Udhëzuesi dhe prioritetet për thirrjen 2021;

2. Formulari i projektpropozimit – **formati Word**;

3. Formulari i Projektbuxhetit – **formati Excel**;

4. Lista e dokumenteve shoqëruese të aplikimit (si më poshtë).

Dokumentet e kërkuara në kuadër të thirrjes:

1. Kopje e statutit/vendimit të gjykatës të organizatës (varianti më i fundit);

2. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT);

3. Vërtetim nga organet tatimore që organizata nuk ka detyrime të pashlyera, për sa

u përket kontributeve për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatim-taksat.

4. Vërtetim i llogarisë bankare të organizatës;

5. Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata, se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv, që nuk janë në proces hetimi apo gjykimi, për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike;

6. Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata për juristët/avokatët e angazhuar pranë organizatës, që nuk janë në proces hetimi apo gjykimi, për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike;

7. Të dhëna për personelin, duke specifikuar detyrat dhe siguruar jetëshkrimin e tyre;

8. Pasqyrat financiare për vitin 2020.

Lista e dokumenteve mbasi janë përzgjedhur projektet fituese:



1. Projektpropozimi i plotë, i shoqëruar me formatin e buxhetit të detajuar;
2. [Udhëzim për mënyrën e kryerjes së pagesave në kuadër të projektit;](#)
3. [Raportimin dhe Monitorimin financiar;](#)
4. [Kontrata tip](#) e miratuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

NJOFTIM
Nr. 2151, datë 4.3.2021

**PËR SHPALLJEN E NJË VENDI
VAKANT PËR POZICIONIN E
SPECIALISTIT TË SEKRETARISË
GJYQËSORE ME KONTRATË TË
PËRKOQSHME (ME KOHË TË PLOTË
DHE ME AFAT JO MË PAK SE 6 MUAJ
DHE JO MË SHUMË SE NJË VIT)**

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e specialistit të Sekretarisë Gjyqësore, me kontratë të përkohshme (me kohë të plotë dhe me afat jo më pak se 6 muaj dhe jo më shumë se një vit), në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: III-b.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë në Drejtësi;
- b) të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- c) të kenë të paktën një vit përvojë pune në profesion.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (originale ose të noterizuar);
4. Dëshmi penalteti;
5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 17 mars 2021, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hënë–të premte ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2021